| | | 10. Kopje te raportit te monitorimit te kontrates nr. 3706, date 22.5.2020.<br>11. Kopje te raporteve te hartuara nga Komiteti per Koordinimin e Kerkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik mbi monitorimin e kushteve dhe vleresimet ne lidhje me shfrytezimin e qendrueshem te peshkut dhe organizmave te tjere detare per 2019-2023.<br>12. Kopje te korrespondences se ministries me institucionet e linjes sipas nenit 19 pika 2 te ligjit 64/2012 pe rlidhjen dhe monitorimin e kontrates nr. 3706 date 22.5.2020 me subjektin “Albligatina” shpk | | | | |
| 32. | 3.7.2023 | Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji për të Drejtën e Informimit 119/2014, kërkohet si informacion:<br>1. Dokumentat standarte të tenderit me kod “REF-93899-04-23-2021” për “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)”.<br>2. Dokumentat standarte të tenderit me kod “REF-30022-05-19-2022” për “Mbrojtjen e gështenjës nga | 27.7.2023 | -PROCEDURË_E_HAPUR_SHËRBIME geshte<br>Procedura_e_hapur_sherbime 2022.docx<br>Procedure_e_Hapur_Sherbime__me_shtojcat | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)”.<br><br>3. Dokumentat standarte të tenderit me kod “REF-68194-05-03-2023” për “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza “galeformuese dryocosmus kuriphilus hymenoptera cynipidae)” | | | | |
| 33. | 14.7.2023 | 1. Si ka fituar kompania “GJERGJI-IMPEX” shpk tenderin me kod “REF-93899-04-23-2021", tenderin me kod "“REF-30022-05-19-2022” dhe tenderin me kod "REF-68194-05-03-2023” kur nuk ka qënë e licencuar?<br><br>2. Në Dogana nuk ka patur import të insektit parazitar “Dryocosmus Kuriphilus Yasumatsu “për të luftuar grerëzën aziatike që po dëmton gështenjat në Shkodër dhe Tropojë.<br><br>Si është kryer luftimi i insektit parazitar kur nuk kemi import të këtij insekti?<br><br>3. Si është përllogaritur struktura e kostos për projektin që lufton grerëzën aziatike? | 28.7.2023 | 1. Sa i takon pyetjes se si ka fituar kompania “Gjergji-Impex” shpk procedurat e prokurimit me objekt “Mbrojtje e gështenjës nga paraziti grerëza “galeformuese dryocosmus kuriphilus hymenoptera cynipidae”, për vitet 2021, 2022 dhe 2023, kur nuk ka qenë i licensuar për kryerjen e kontrollit biologjik, ju sqarojmë se në dokumentat standarte të tenderit për këto procedura prokurimi nga Autoriteti Kontraktor (MBZHR) janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit që duhet të plotësojë një ofertues për kryerjen e këtij shërbimi, të cilat i ka plotësuar shoqëria “Gjergji-Impex” shpk në procedurat që është shpallur fitues.Në Ligjin Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti; 4.1. Licencë Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve 5.2. Licencë Shërbime të riprodhimit, | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | krijimit të racave ose veterinare 6.3 Licencë Rritja ose tregtimi i kafshëve 7.4. Licencë Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve 8 5. Licencë Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve 9.6. Licencë Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë".Shërbimi i kërkuar në procedurën e prokurimit me objekt "Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza "galeformuese dryocosmus kuriphilus hymenoptera cynipidae", nuk përfshihet në kategoritë e licensave të parashikuara në fushën e ushqimit dhe shëndetit, konkretisht:<br><br>1. "Licencë Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare", jepet për veprimtari të mbajtjes së kafshëve për riprodhim, ndërsa parazitoidi (Torymus sinensis) importohet për t'u përdorur për luftimin dhe mbrojtjen e gështenjës nga grerëza galëformuese (Dryocosmus kuriphilus) dhe nuk janë për riprodhim apo krijim racash;<br><br>2. "Licencë Rritja ose tregtimi i kafshëve", e cila ndahet në nënkategoritë:<br><br>1. Mbarështimi i kafshëve në fermat agroblegtorale të mëdha (me mbi 50 "njësi gjedhi")"- me kodin II. 3.A; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2. “Kultivimi i kafshëve ujore në fermat e akuakulturës” - me kodin II.3.B;<br>3. “Tregtia me shumicë e kafshëve të gjalla”, me kodin II.3.C;<br>4. Importi i kafsheve të gjalla, me kodin II.3.D<br>Në interpretim të këtij parashikimi rezulton se shërbimi i kërkuar në procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza “galeformuese dryocosmus kuriphilus hymenoptera cynipidae”, nuk bën pjesë të asnjë nga nënkategoritë e sipërcituara, parazitoidi nuk do të përdoret për mbarështrim, kultivim, tregëti, por është një mjet luftimi për mbrojtjen e gështenjës.<br>2. Lidhur me pretendimin se në Dogana nuk ka patur import të insektit parazitar “Dryocosmus Kuriphilus Yasumatsu” për të luftuar grerëzën aziatike që po dëmton gështenjat në Shkodër dhe Tropojë dhe mënyrën se si është kryer luftimi i insektit parazitar kur nuk kemi import të këtij insekti, sqarojmë se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton që të ketë import të këtij parazitoidi në Zyrat Doganore, Drejtoria e Doganave, Shqipëri. Luftimi i parazitit është kryer | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | me sukses dhe është monitoruar nga MBZHR dhe pushteti vendor.<br><br>3. Për llogaritjen e strukturës së kostos për projektin që bën këtë luftim, sqarojmë se përllogaritja është kryer referuar parashikimeve të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X “Zhvillimi i procedurave”, neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, në të cilën parashikohet se: “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky stutdim ose/dhe c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore”. | | |
| 34. | 21.7.2023 | 1. A ka një listë specifike të PMB te miratuara nga Ministria e Bujqesise per perdorim ne tokat bujqesore qe ndodhen brenda dhe afer Zonave te Mbrojtura?<br><br>2. Cili eshte mekanizmi per te kontrolluar zbatimin e ligjit per perdorimin e PMB te lejuara në Zonat e Mbrojtura? | 8.8.2023 | kthim pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Ne cmase eshte perdorimi i PMB qe nuk jane pjese e listes se miratuar prej ministrise, nga ana e fermereve?<br><br>4. Cfare impakti ka ne produktin e fermereve perdorimi i PMB ne sasi dhe shpeshtesi me teper nga sa lejohet?<br><br>5. Ne zonen e Korces kultivimi i pemtoreve ne te cilat perdorimi i PMB eshte i pakontrolluar ka rritur shqetesimin per ndotje te larte te mjedisit sidomos te ujrave te liqeneve te Ohrit dhe Prespes.<br><br>A ka ndjekur ministria politika per orientimin e fermereve drejt kultivimit te arrorëve, si kultura me impakt negativ me te ulet per mjedisin?<br><br>6. Sa eshte numri i rekomanduar i sperkatjeve qe duhet te bejne ne vit fermeret per mollen?<br><br>7. Sa eshte siperfaqja totale e kultivuar me molle brenda zonave te mbrojtura apo ne afersi te tyre ne qarkun e Korçes?<br><br>8. SI paraqitet situata e perdorimit te produkteve te ndaluara apo kontrabande ne keto zona dhe cilat jane pasojat qe shkaktohen nga perdorimi i tyre?<br><br>9. Nga kontrollet e insytitucioneve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë cilat janë PMB që hyjnë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontrabandë në treg dhe tek cilat kultura përdoren ato?? | | | | |
| 35. | 26.7.2023 | Sipas korrenspondencës me Doganat Shqiptare kemi zbuluar se insekti i prodhuar në laborator biologjik "Torymus Sinensis Kamijo" nuk rezulton të jetë importuar në vendin tonë për vitet 2021, 2022 dhe 2023. Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka deklaruar në media se insekti "Torymus Sinensis Kamijo" është importuar nga një laborator i certifikuar i Bashkimit Europian.<br>1. Cili është komenti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për këtë informacion nga Doganat?<br>2. Nëse Ministria e Bujqësisë pretendon që ky insekti "Torymus Sinensis Kamijo" është importuar nga një laborator i certifikuar nga Bashkimi Europian, kush është laboratori që e ka importuar insektin "Torymus Sinensis Kamijo" për vitet 2021, 2022 dhe 2023? | 15.8.2023 | Eksportuesi i parazitoidit (Torymus sinensis) për luftimin e grerezes galeformuese të geshtenjes për procedurat e prokurimit për vitet 2020-2023 është shoqëria OASIS SRL, Itali. | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |
| 36. | 28.7.2023 | Dokumentat Standarte të Tenderit me kod "REF-57897-05-12-2020" me objekt prokurimi "Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)" të organizuar nga | 15.8.2023 | Eksportuesi i parazitoidit (Torymus sinensis) për luftimin e grerezes galeformuese të geshtenjes për procedurat e prokurimit për vitet 2020- | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020.<br>1. Emrin e laboratorit nga është importuar insekti “Torymus Sinensis Kamijo” për vitin 2020 në Shqipëri sipas kontratës për mbrojtjen e gështenjave nga grerëza aziatike.<br>2. Emrin e laboratorit nga është importuar insekti “Torymus Sinensis Kamijo” për vitin 2021 në Shqipëri sipas kontratës për mbrojtjen e gështenjave nga grerëza aziatike.<br>3. Emrin e laboratorit nga është importuar insekti “Torymus Sinensis Kamijo” për vitin 2022 në Shqipëri sipas kontratës për mbrojtjen e gështenjave nga grerëza aziatike.<br>4. Emrin e laboratorit nga është importuar insekti “Torymus Sinensis Kamijo” për vitin 2023 në Shqipëri sipas kontratës për mbrojtjen e gështenjave nga grerëza aziatike. | | 2023 është shoqëria OASIS SRL, Itali.<br>PROCEDURË_E_KUFIZUAR_SHERBIME 2020. | | |
| 37. | 25.7.2023 | Në lidhje me zbatimin e “Marrëveshjes për Bashkëpunim në Fushën e Veterinarisë, Ushqimit dhe Sigurisë Ushqimore dhe Fitosanitare në Ballkanin Perëndimor”, Ju lutem vendosjen në dispozicion të informacioneve si më poshtë vijon: − Datën e ratifikimit nga Qeveria e | 8.8.2023 | Pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shqipërisë dhe numrin e aktit (nëse ka); − Një kopje të formatit të certifikatës fitosanitare për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të dakordësuar dhe harmonizuar ndërmjet Palëve sipas nenit 1 të “Marrëveshjes për Bashkëpunimin në Fushën e Veterinarisë, Ushqimit dhe Sigurisë Ushqimore dhe Fitosanitare në Ballkanin Perëndimor”. − Një kopje e të gjitha formatit të certifikatës të dakordësuar dhe harmonizuar për produktet e listuara në listën V, Pjesa B (sipas kategorive apo elementëve të listës). − Opinionin e përgatitur nga institucioni mbi vlerësimin e përputhshmërisë së “Marrëveshjes për Bashkëpunimin në Fushën e Veterinarisë, Ushqimit dhe Sigurisë Ushqimore dhe Fitosanitare në Ballkanin Perëndimor” me acquis të BE-së (nëse ka). Gjithashtu, një listë e akteve të legjislacionit të BE-së dhe neneve specifike me të cilat kjo marrëveshje është në përputhje, dhe aktet e legjislacionit të BE-së dhe nenet specifike me të cilat kjo marrëveshje nuk është në përputhje; − Kopje të protokollit shtesë që rregullon kostot në lidhje me kontrollet e importit dhe eksportit, sipas nenit 6 të “Marrëveshjes për Bashkëpunimin në Fushën e Veterinarisë, Ushqimit dhe Sigurisë Ushqimore dhe Fitosanitare në Ballkanin | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Perëndimor”. − Listë e tarifave fiskale dhe parafiskale të ndryshuara si rezultat i miratimit të këtij protokolli, duke përfshirë edhe vlerat e tyre para dhe pas miratimit të protokollit.<br>− Informacion mbi të ardhurat e fituara ose të humbura si rezultat i miratimit të Protokollit, për tarifën fiskale ose parafiskale dhe në total (nëse ka); − Raport (e) monitorimi mbi zbatimin e marrëveshjes; − A disponon institucioni hapësirën fizike dhe infrastrukturën teknike për të mundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje (zyra, poste pune, pajisje teknike dhe teknologjike)? − A disponon institucioni stafin e nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje? − Çdo informacion tjetër apo angazhim të punonjësve të institucionit në kuadër të Nismës Ballkani i Hapur. | | | | |
| 38. | 25.7.2023 | Në lidhje me zbatimin e “Marrëveshjes për Mekanizmat e Sigurisë Ushqimore në Ballkanin Perëndimor”, Ju lutem vendosjen në dispozicion të informacioneve si më poshtë vijon: − Datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes (ratifikimi nga Qeveria e Shqipërisë) dhe numrin e aktit përkatës (nëse ka); − Vendimin/dokumentin ose aktin për krijimin e Grupit të Përbashkët të Punës sipas nenit 4 të “Marrëveshjes për Mekanizmat e Sigurisë Ushqimore në Ballkanin | 8.8.2023 | Pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Perëndimor”; − Listë e anëtarëve të Grupit të Përbashkët të Punës, duke përfshirë emrat dhe mbiemrat e tyre, pozicionin e punës, institucionin dhe shtetin. − Kopje të përfundimeve të takimeve të Grupit të Përbashkët të Punës të mbajtura nga ngritja deri më sot; − Dokumentet/aktet e miratuara nga Grupi i Përbashkët i Punës; − Opinionin e përgatitur nga institucioni mbi vlerësimin e përputhshmërisë së “Marrëveshjes për Mekanizmat e Sigurisë Ushqimore në Ballkanin Perëndimor” me acquis të BE-së (nëse ka). Gjithashtu, një listë e akteve të legjislacionit të BE-së dhe neneve specifike me të cilat kjo marrëveshje është në përputhje, dhe aktet e legjislacionit të BE-së dhe nenet specifike me të cilat kjo marrëveshje nuk është në përputhje;<br><br>− Kopje të Planit të Përbashkët të Politikës për përmirësimin e kapaciteteve për produktet thelbësore agro-ushqimore, të zhvilluar sipas nenit 6 të “Marrëveshjes për Mekanizmat e Sigurisë Ushqimore në Ballkanin Perëndimor”; − Raportet e monitorimit për nivelin e zbatimit të Planit të Politikës së Përbashkët; − Listën e aktiviteteve të zbatuara të Planit të Politikës së Përbashkët, duke përfshirë informacionin për periudhën e zbatimit, institucionet | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përgjegjëse dhe zbatuese, buxhetin e ndarë dhe të realizuar, rezultatet e arritura për aktivitet. − Listën e aktiviteteve të planifikuara të Planit të Politikës së Përbashkët, duke përfshirë informacionin për periudhën e zbatimit, institucionet përgjegjëse dhe zbatuese, buxhetin e ndarë dhe të realizuar, rezultatet e pritura për aktivitet. − Dokumentin Udhërrëfyesi për Sigurinë Ushqimore (Nisma Ballkani i Hapur) / Planin e Veprimit 2030, të zhvilluar sipas nenit 8 të "Marrëveshjes për Mekanizmat e Sigurisë Ushqimore në Ballkanin Perëndimor". − Raportet e zbatimit të Udhërrëfyesi për Sigurinë Ushqimore (Nisma Ballkani i Hapur) / Planin e Veprimit 2030; − Listën e aktiviteteve të realizuara nga Udhërrëfyesi për Sigurinë Ushqimore (Nisma Ballkani i Hapur) / Plani i Veprimit 2030, duke përfshirë informacionin për periudhën e zbatimit, institucionet përgjegjëse dhe zbatuese, buxhetin e ndarë dhe të realizuar, rezultatet e arritura për aktivitet. − Listën e aktiviteteve të planifikuara në Udhërrëfyesin për Sigurinë Ushqimore (Nisma Ballkani i Hapur) / Plani i Veprimit 2030, duke përfshirë informacionin për periudhën e zbatimit, institucionet përgjegjëse dhe zbatuese, buxhetin e alokuar, rezultatet e pritura për aktivitet. − A disponon institucioni | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | hapësirën fizike dhe infrastrukturën teknike për të mundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje (zyra, poste pune, pajisje teknike dhe teknologjike)? − A disponon institucioni stafin e nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje? − Çdo informacion tjetër apo angazhim të punonjësve të institucionit në kuadër të Nismës Ballkani i Hapur. | | | | |
| 39. | 28.7.2023 | Në bazë të ligjit për të Drejtën e Informimit nr.119/2014, ne kërkojmë si informacion:<br><br>1. Dokumentat Standarte të Tenderit me kod “REF-57897-05-12-2020" me objekt prokurimi "Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)" të organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020. | 15.8.2023 | PROCEDURË_E_KUFIZUAR_SHERBIME 2020.<br><br>Eksportuesi i parazitoidit (Torymus sinensis) për luftimin e grerezes galeformuese të geshtenjes për procedurat e prokurimit për vitet 2020-2023 është shoqëria OASIS SRL, Itali. | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |
| 40. | 4.9.2023 | Kërkoj relacionet shpjeguese për vkm nr. 461, datë 26.7.2023 “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave për zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”<br><br>Vkm nr. 486, datë 1.8.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 347, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së | 14.9.2023 | Relacioni per miratim 1772023.docx<br><br>Relacioni per miratim.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e<br><br>vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private"” | | | | |
| 41. | 17.8.2023 | Në bazë të ligjit për të Drejtën e Informimit nr.119/2014, ne kërkojmë si informacion:<br><br>1. Dokumentin e certifikatës së origjinës nga laboratori Italian për importin e insektit për mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)" për tenderin e organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020.<br><br>2. Dokumentin e certifikatës së origjinës nga laboratori Italian për importin e insektit për mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)" për tenderin e organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2021.<br><br>3. Dokumentin e certifikatës së origjinës nga laboratori Italian për importin e insektit për mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)" për tenderin e organizuar nga Ministria e | 28.9.2023 | Autorizimi i laboratorit italian.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2022.<br><br>4. Dokumentin e certifikatës së origjinës nga laboratori Italian për importin e insektit për mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)" për tenderin e organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2023. | | | | |
| 42. | 11.9.2023 | Bazuar ne ligjin 119/2014 per te drejten e informimit kërkoj të më vendosen në dispozicion informacionet si më poshtë:<br><br>1. Sa është sipërrfaqja e tokës torfike në Shqipëri?<br><br>2. Ku gjenden sipërfaqet torfike dhe si janë sipërfaqet e tyre sipas zonave?<br><br>3. Në ccfarë mase është sitemi i vaditjes dhe i kullimit në këto sipërfaqe?<br><br>4. Cilat janë fenomenet natyrore që kërcënojnë sipërfaqet torfike?<br><br>5. Cfarë masash ka parashikuar ministria për mbrojtjen e tyre nga djegia dhe përmbytja?<br><br>6. Sa është sipërfaqja e tokës torfike në bashkinë e Maliqit?<br><br>7. Cfarë dëmi sjell djegia e torfës për bujqësinë në zonën e Maliqit? | 28.9.2023 | pergjigja.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 8. Ka MBZHR strategj për mbrojtjen e tokave torfike?<br>9. Cfarë parashikon ajo?<br>10. A është investuar për 5 vitet e fundit në fushën torfike të Maliqit dhe zonat e tjera torfike të vendit?<br>11. Në cfarë mase është investimi dhe ku konsiston? | | | | |
| 43. | 19.9.2023 | Ju lutem na vini në dispozicion informacionin e detajuar në lidhje me pyetjet si vijojnë:<br>1.Sa pika grumbullimi për produktet bujqësore (fruta, vaj ulliri, etj.) ka në Bashkinë e Elbasanit?<br>2. Si është menduar krijimi i pikave të grumbullimit për Bradasheshin, Gjergjan dhe Shushicë?<br>3. Kur do të krijohen këto pika? Cili është afati? Në cilën adresë është menduar të ndërtohen këto pika?<br>4. Cilave zona (fshatrat/njësi administrative) do t'u shërbejnë këto pika?<br>5. Sa do të kushtojë investimi?<br>6. Në cilën fazë janë punimet për pastrimin dhe sistemimin e përroit/gurrës së Shushicës?<br>7. Në çfarë konsiston, teknikisht, procedura e pastrimit dhe sistemimit? | 4.10.2023 | pergjigje (2).docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 8. Cilat janë afatet e përfundimit?<br>9. Sa është vlera e investimit?<br>10. Sa sipërfaqe do të përfshihet në pastrim dhe sistemim? Në cilat zona? | | | | |
| 45. | 22.9.2023 | BE ka nisur hetimet lidhur me menaxhimin e fondeve që ata kanë akorduar për Ministrinë e Bujqësisë,<br>programi IPARD. Sa punonjës të ministrisë tuaj apo institucioneve nën varësi, janë duke u hetuar për këtë problematike të deklaruar nga BE dhe në ç'fazë janë këto hetime?<br>A ka nisur SPAK një hetim lidhur me këtë çështje?<br>A ka një kohë kur mund të rikthehet normaliteti mes ministrisë dhe BE-së për vazhdimin e fondeve të progamit IPARD, me përfundimin e këtyre hetimeve? | 12.10.2023 | Pergjigje (3).docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |
| 46. | 2.10.2023 | Kopje te akteve nen ligjore per mènyren e vleresimit tè bredhit per llogari tè Agjencisè Kombètare tè Shpronèsimit (e organizuar nè bazè tè ligjit nr. Nr.856l, datè 22.12.1999 “Për shpronèsimet dhe marrjen nè pèrdorim tè pèrkohshèm tè pasurisè pronè private pèr interes publik”)<br>Kopje tè akteve tè vlerèsimit tè pemève tè bèra nga Ministria e Bujqèsisè tè viteve 2020-2023 pèr llogari tè AKSH-it | 12.10.2023 | Ne lidhje me kerkesen tuaj per informacion ju bejme me dije se vleresimi teknik dhe perllogaritja e kulturave bujqesore drufrutore dhe jo pyjet (bredhit) behet nga strukturat pergjegjese rajonale bujqesore, ne varesi te Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural.<br>Ne varesi te rastit konkret dhe vendodhjes se ketyre kulturave duhet ti drejtoheni Agjencise Rajonale te Ekstensionit Bujqesor perkates pergjegjes per ate territor, i cili | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | administron procesverbalet e vleresimit.<br><br>Udhezimi nr. 1, date 5.10.2000 "Per kriteret teknike te perllogaritjes se vleres se bimeve drufrutore qe shpronesohen per interes publik ne rastin kur mungojne tregusesit e deklaruar te shtiblerjes" eshte akti nenligjor qe zbatojne AREBt per vleresimin e kulturave drufrutore. | | |
| 47. | 2.10.2023 | Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji për të Drejtën e Informimit nr. 119/2014, kërkoj si informacion:<br><br>1. Listën me emrat e plotë të subjekteve që u ndaluan nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të importonin mish nga Brazili për vitin 2015.<br><br>2. Listën me emrat e plotë të subjekteve që u ndaluan nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të importonin mish nga Brazili për vitin 2016.<br><br>3. Listën me emrat e plotë të subjekteve që u ndaluan nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të importonin mish nga Brazili për vitin 2017. | 16.10.2023 | Urdher 131 BRAZIL.pdf<br>Urdher mishi Brazilit.pdf<br>Shtese ne urdhrin per kontrollin e ngarkesav<br><br>Pezullimi i subjekteve ka ardhur si veprim, nga informacioni i përcjellë nga Ministria e Punëve të Jashtme, me anë të së cilës na ka informuar në lidhje me një skandal të ndodhur në Brazil, nga hetimet e secilit janë arrestuar 40 inspektore ushqimi dhe në të njejtën kohë ka përcjelle edhe listat e stabilimenteve të pezulluara. | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 48. | 9.10.2023 | Kërkoj vendosjen në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural per:<br><br>Vkm Nr. 515 date 30.8.2023 “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në lehtësimin e procedurave në pikat e inspektimit kufitar, për produktet me origjinë joshtazore”<br><br>Vkm Nr. 529, date 7.9.2023 “Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “Tokë bujqësore” në “Tokë urbane/ truall”, për sipërfaqen 312 m2, pjesë e pasurisë me nr.1, zona kadastrale 2264, Bashkia Finiq”<br><br>Vkm Nr. 538, date 13.9.2023 “Për miratimin e marrëveshjes së zbatimit, për projekte të bashkëpunimit teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe (GIZ) GMBH” | 19.10.2023 | Relacionipermiratim.docx Relacionipermiratimin.docx Relacionimiratimitpasnenshkrimit.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |
| 49. | 16.10.2023 | 1. Sa është shuma që ka financuar BE për programin e IPARD I, II, dhe III dhe si është ndarë ajo në sektorë të ndryshëm? | 30.10.2023 | Informacioni IPARD.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Si ndahet financimi mes sektorëve dhe projekteve?<br>3. Si funksionon procesi i monitorimit dhe raportimit për projektet e financuara ngaIPARD?<br>4. Çfarë kriteresh të përgjithshme dhe të përveçme duhet plotësuar për të aplikuar për projektet e programit IPARD I, II dhe III?<br>5. A ka detyra ose obligime specifike që duhet të plotësohen pas marrjes së financimit?<br>6. Cilat janë masat e zbatuara për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien në përdorimin e fondeve të IPARD?<br>7. Cilat janë masat për parandalimin e mashtrimeve dhe keqpërdorimeve të fondeve të IPARD nga aplikantët dhe autoritetet vendore?<br>8. Cilat janë kriteret dhe procedurat për zbatimin e fondit të IPARD nga qeveria vendore? | | | | |
| 50. | 23.10.2023 | Sa është shuma e paguar për konsumin e energjisë elektrike për periudhën 01.10.2021 – 20.10.2023? (të ndara sipas muajve) | 1.11.2023 | Energjia elektrike tetor 2023.xlsx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |
| 51. | 6.11.2023 | kërkoj të pajisem me informacionin si më poshtë: Në përputhje me Programin" Për menagjimin e qëndrueshëm të Tokës Bujqësore" të realizuar në përputhje me udhëzimin nr. 7, datë | 20.11.2023 | Programi i Mernaxhimit të Qëndrueshëm të Tokës Bujqësore që implementohet nga QTTB Fushë-Krujë krijon sistemin e informacionit mbi tokën bujqësore dhe integrimin e tij në | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 10.05.2010 "Për krijimin e informacionit mbi tokën bujqësore nga zbatimi i programit "Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore", për vitin 2010" kërkoj një evidencë përmbledhëse mbi të cilën ky program është i shtrirë në të gjithë Republikën e Shqipërisë( Emrat e Qarqeve, Emrat e Bashkive, Emrat e ish-Komunave që tani janë njësi administrative). | | sistemin e informacionit gjeografik GIS. Produkti i këtij programi është shtrirë në bashki dhe në fshatra sipas tabelës bashkëlidhur. Gjithashtu, për më shume informacion, linku i mëposhtëm:<br>https://informacionipertoken.qttbfushekruje.gov.al/portal/home/<br>Statistika LIS sipas qarqeve.xlsx | | |
| 52. | 9.11.2023 | Kërkoj vendosjen në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rura per Vkm Nr. 613, date 27.10.2023 "Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit" | 22.11.2023 | Relacioni per miratim ne KM (1).docx | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |
| 53. | 17.11.2023 | 1- Cilat janë Prokuroritë e rretheve që kanë depozituar pranë QTTB-ve kërkesa për kryerjen e kultivimit të farave të sekuestruara në kuadër të procedimeve penale?<br>2- Nëse ka, sa është numri i kërkesave ende të papërfunduara të depozituara pranë ndonjë QTTB-jepër kryerje të kultivimit të farave të sekuestruara kuadër të procedimeve të tyre penale.<br>3- Nëse aktualisht pranë QTTB-ve nuk ka asnjë kërkesë të | 22.11.2023 | Kthim pergjigje.docx<br>Njoftimi_17.03.2021.jpeg<br>QTTB Shkoder.pdf<br>Skresa nr.227,dt.06.11.2023.p<br>Proces-verbal-shkrese.pdf<br>refuzim per vazhdimin e testimit fa | Përgjigja i është dhënë e plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | prokurorisë të papërfunduar, kur është paraqitur kërkesa e fundit nga prokuroria e rretheve për kryerje të kultivimit të farave të sekuestruara në kuadër të procedimeve të tyre penale.<br><br>4- Njoftimin (nëse ka) të Urdhërit/Udhëzimit/Qarkores, etj., ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, që autorizon kryerjen apo urdhëron ndalimin ose ndërprejen nga QTTB-të trajtimit të kërkesave të Prokurorive të rretheve për kultivim të farave të sekuestruara në kuadër të një ekspertimi.<br><br>5- Akti i Pokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit apo aktin e Ministrit të Bujqësisë që ngarkon ndonjë nga QTTB-të me kompetencë për të kryer kultivimin e farave të sekuestruara në kuadër të një procedimi penal, të dyshuara si fara të bimëve narkotike.<br><br>6- Refuzimi zyrtar (nëse ka) të Ministrit të Bujqësisë apo refuzimin zyrtar të ndonjë prej drejtuesve të QTTB-së drejtuar Pokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit apo Institutit të Policisë Shkencore, për kryerjen apo vazhdimin e kryerjes së kultivimit | | refuzim per vazhdimin e testimit fa<br>Njoftimet.pdf<br>CamScanner 11-20-2023 11.08.pdf | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të farave të sekuestruara në kuadër të një ekspertimi. | | | | |
| 54. | 22.11.2023 | Kerkoj venien ne dispozicion te shkreses me nr. 1656/1 prot., date 15.3.2022 qe MBZHR i eshte drejtuar Prokurorit te Pergjithshem per kerkese per bashkepunim | 23.11.2023 | 20231123_091445.jpg 20231122_160347.jpg | | |